

VENDIM
Nr.861, datë 23.6.2009

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, AGJENCIVE TË ORGANIZATËS
SË KOMBEVE TË BASHKUARA, TË OBJEKTIT “REPARTI I PRESTARISË DHE
ZYRA”, NË ADMINISTRIM TË “NPV USHTRISË”, SHA, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve””, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Dhënie në përdorim, pa shpërblim, agjencive të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për një periudhë 10 (dhjetëvjeçare), të objektit “Repart i prestarisë dhe zyra”, në administrim të “NPV ushtrisë”, sh.a. Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 5 251,4 (pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një presje katër) m², nga të cilat 2 071,4 (dy mijë e shtatëdhjetë e një presje katër) m², sipërfaqe funksionale, për pajisjen e këtyre agjencive me zyra.

2. Autorizimin e Ministrisë së Mbrojtjes për të lidhur kontratën me këto agjenci.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha